



## Lobing për rritjen e fondeve për sektorin e bujqësisë nga buxheti i shtetit

### Konteksti i projektit

Zhvillimet e fundit në Shqipëri janë shoqëruar me ndryshime pozitive që reflektohen në një perceptim të ri në përgatitjen e buxhetit në kuadrin legal ashtu dhe në përmbajtje dhe prezantim. Një buxhet koherent ndihmon dhe lehtëson procedurë e aprovimit dhe zbatimin në kohë të investimeve. Duke patur parasysh zhvillimet e fundit të ekonomisë në vend dhe impaktin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, është arritur në konkluzionin që në kushtet e një politike të duhur për ambientin dhe e një mbështetjeje të shtetit në inkurajimin e investimeve private në bujqësi, Shqipëria ka një klimë të përshtatshme dhe një potencial të konsiderueshëm për një zhvillim modern dhe konkurrues të sektorit të bujqësisë.

### Qëllimi i projektit

Ky projekt kishte si qëllim organizimin e një studimi sensibilizues dhe informues për rritjen e buxhetit në sektorin e bujqësisë dhe për një menaxhim më të mirë të fondeve që përdoren për investime në këtë sektor. Përgatitja e një seti rekomandimesh dhe sugjerimesh për përmirësimin e përgatitjes dhe zbatimit të buxhetit për zonat rurale.

### Fazat e projektit

#### Faza 1: Studim në nivel kombëtar

Përgatitja e një analize krahasuese mbi buxhetin rural dhe zbatimin e tij gjatë periudhës 2003-2008 të faktorëve kryesorë të përfshirë dhe të kuadrin ligjor që kontrollojnë këtë proces. Kjo ishte dhe rezultati i gërshetimit të një pune studimore në lidhje me aspektin ligjor, të dhënat për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, alokimi i fondeve në vite si dhe ndryshimet e reja të reflektuara në procesin e buxhetimit. Gjithashtu faza e parë përfshiu dhe studimin e një sërë praktikash ndërkombëtare në lidhje me dizajnimin dhe menaxhimin e buxhetit rural, veçanërisht nga vende fqinje me kushte



zhvillimi dhe tranzicioni të ngjashme me Shqipërinë.

#### Faza 2: Konkluzionet finale dhe rekomandimet

Kjo pjesë e projektit u përqendrua në përgatitjen e një seti me rekomandime dhe sugjerime për ndryshime në ndarjen e buxhetit për sektorin e bujqësisë që reflektonin zhvillimin makroekonomik të vendit në përgjithësi dhe të këtij sektori në veçanti, konkretisht:

- Neje sistem informimi dhe raportimi që mundëson efikasitet në një proces vendimmarrjeje;
- Indikator të performacës financiare që mundësojnë analizen e tendencave dhe krahasimeve ndersektoriale;
- Lidhjen ndërmjet buxhetit kombëtar dhe treguesve të pritshëm që mbështesin zhvillimin e bujqësisë.

### Përfundimet

Konkluzioni kryesor i mbështetur mbi analizen e përgjithshme të studimit thekson, mbështetur mbi një tëresi argumentash, një alokim më të madh të fondeve nga buxheti i shtetit për sektorin e bujqësisë. Bujqësia është një nga segmentet më të rëndësishëm të zhvillimit të ekonomisë së një vendi, dhe kjo vlen dhe për Shqipërinë. Nga shumë studime është mbështetur fakti i një lidhjeje pozitive ndërmjet investimeve të konsiderueshme

në bujqësi dhe uljes së varferisë në zonat rurale gjë që kontribuon direkt në rritjen e mirëqënies ekonomike të një vendi. Është e rëndësishme të ndergjegjesohet opinionin e përgjithshëm në lidhje me kërkesat dhe nevojat esenciale të popullsisë në zonat rurale, të pjesëmarrjes së komunitetit në përgatitjen e buxhetit, të strategjive kombëtare dhe të praktikave të suskeshme nga vendet fqinje dhe të gjithë këto faktorë së bashku udhëheqin një vend drejt një zhvillimi progresiv.

### FAKTET KRYESORE

#### PARTNERET:

✓ OXFAM

#### KOHËZGJATIA:

2006

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: [uri@uri.org.al](mailto:uri@uri.org.al)  
Web: [www.uri.org.al](http://www.uri.org.al)

### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.